Autoriteti Kombëtar i Kualifikimeve
Nacionalni Autoritet za Kvalifikacije
National Qualification Authority

RAPORT VJETOR

I AUTORITETIT KOMBËTAR TË KUALIFIKIMEVE PËR VITIN

2018

www.akkks.rks-gov.net



www.akkks.rks-gov.net

Përmbajtja:

Fjala hyrëse 4
Përbërja e Këshillit Drejtues 6
Organogrami i AKK 7
Misioni 8
Synimet dhe objektivat 9
Akterët e rëndësishëm 10
Konteksti 10
Planifikimi 11
Plani i punës 2018 12
Rregullimi i Kornizës Kombëtare të Kualifikimeve (KKK) 16
Validimi i kualifikimeve në KKK dhe akreditimi i Institucioneve të Arsimit dhe Aftësimit Profesional 18
Vizitat në institucione 19
Përpilimi i raportit të vlerësimit për validim dhe akreditim 20
Sektori i monitorimit 24
Promovimi i KKK-së dhe AKK-së 26
Botimi i materialeve 30
Cikli i cilësisë 31
Prezantimi në medie elektronike dhe të shkruara 32
Mirëmbajtja dhe përditësimi i uebfaqes 32
Bashkëpunimi ndërkombëtar 33



LAH NITAJ

Drejtor i AKK

Fjalë hyrëse

Ndër institucionet e rëndësishme në Republikën e Kosovës që ndihmon fushën e Arsimit dhe Aftësimit Profesional (AAP) dhe të rinjtë tanë; nxënës, studentë dhe të rritur, është Autoriteti Kombëtar i Kualifikimeve (AKK). Autoriteti Kombëtar i Kualifikimeve është themeluar nga MAShT, me anë të Ligjit për Kualifikimet Kombëtare, si organ i pavarur publik, përgjegjës për zhvillimin dhe mbarëvajtjen e Kornizës Kombëtare të Kualifikimeve (KKK) dhe dhënien e kualifikimeve brenda kornizës.

Autoriteti funksionon sipas ligjit, udhëzimeve administrative përkatëse dhe Kornizës Kombëtare të Kualifikimeve (KKK). Autoriteti ka Këshillin Drejtues prej trembëdhjetë (13) anëtarëve, të cilët përfaqësojnë ministritë dhe partnerët social si dhe universitetet publike. Këshilli takohet së paku gjashtë (6) herë në vit.

Sipas strukturës organizative AKK ka; Drejtorin, Sektorin e sigurimit të cilësisë, Sektorin e kualifikimeve, Sektorin për standarde, Sektorin për monitorim dhe zyrën administrative. Në AKK janë të punësuar gjithsej shtatë (7) veta.

Autoriteti ka përgjegjësinë ligjore që t'i validoi programet dhe t'i akreditoj institucionet e AAP, ta mbikëqyrë cilësinë arsimore të tyre, t'i verifikoj dhe aprovoj Standardet profesionale dhe ta monitoroj punën dhe rregullsinë e të gjitha institucioneve të akredituara.

AKK bën përcaktimin e niveleve të kualifikimeve në Kornizën Kombëtare të Kualifikimeve, harmonizimin e niveleve të kualifikimeve me Kornizën Evropiane të Kualifikimeve (KEK), caktimin e kritereve për aprovimin e kualifikimeve dhe akreditimin e institucioneve të Arsimit dhe Aftësimit Profesional (AAP), përfshirjen e kualifikimeve të aprovuara në KKK, lehtësimin e progresit dhe transferit ndërmjet formave të ndryshme të të mësuarit dhe sigurimin e cilësisë në institucionet e akredituara të AAP-së.

Përkushtimi ynë, është ngritja e cilësisë arsimore që mundëson marrjen e dijeve dhe shkathtësive për një profesion dhe vende pune për të rinjtë, pa i privuar ata nga shkollimi sipëror dhe karriera profesionale. AKK e ndihmon këtë proces në mënyrë të vazhdueshme. Për këtë, vlerësohemi gjithandej si një institucion kombëtar i besueshëm në fushën e arsimit dhe aftësimit profesional i cili ka ndërtuar identitetin dhe kredibilitetin e nevojshëm.

Angazhim të posaçëm kemi bashkëpunimin dhe koordinimin me institucione publike e private; MAShT, qeveri, ministri të linjës, Këshilli Drejtues, komunat dhe shkollat dhe ofruesit e arsimit dhe aftësimit profesional.

Gjatë vitit 2018, e kemi zgjeruar bashkëpunimin ndërkombëtar, nga kemi përfituar ekspertizë dhe përvoja të rëndësishme për punën tonë, duke qenë të përgjegjshëm për rëndësinë që ka arsimi në rrugën e integrimeve evropiane.

Po kështu, është punuar me përkushtim për verifikimin dhe aprovimin Standardeve profesionale, janë validuar programe dhe akreditуar shumë institucione në fushën AAP-së, janë monitoruar një numër i institucioneve të akredituara dhe janë bërë vizita për rishikim të kushteve të akreditimit. Kujdes i veçantë është bërë për vlerësimin e cilësisë në institucionet që janë akreditуar. Deri tani janë verifikuar dhe aprovuar 93 Standarde profesionale, janë akreditуar mbi 50 institucione dhe rreth 40 kualifikime kombëtare.

Shpresojmë se me përkushtimin dhe punën tonë e kemi përmbushur obligimin ligjor në raport me qytetarët dhe institucionet e vendit.

Përbërja e Këshillit Drejtues:

Bedri Xhafa	Kryetar, Agjencia e Përkrahjes së Punësimit në Kosovë (APPK)
Teuta Danuza/Blerta Perolli Shehu	Nënkryetare, Universiteti i Prishtinës (UP)
Arjeta Emra	Anëtare, British Council
Agim Shahini	Anëtar, Aleanca Kosovare e Biznesit (AKB)
Fetije Huruglica	Anëtare, Ministria e Shëndetësisë (MSH)
Lulzim Krasniqi/Enver Hajrullahu	Anëtar, Ministria e Tregtisë dhe Industrisë (MTI)
Besim Mustafa	Anëtar, Oda Ekonomike (OE)
Gëzim Isufi	QSE "Don Bosko"
Mehreme Llumnica	Anëtare, Handikos
Peonare Caka/Visar Jasiqi	Anëtar/e, Universiteti Amerikan i Kosovës (AUK)
Jehona Namani	Anëtare, Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale (MPMS)
Furtuna Mehmeti	Anëtare, Agjencia e Kosovës për Akreditim (AKA)
Ardita Dushi/Lulzim Rafuna	Ministria e Financave (MF)

Në shtator të vitit 2018, me vendim të Qeverisë së Kosovës është aprovuar përbërja e re e Këshillit Drejtues:

Violeta Dema	Kryetare, Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë (MAShT)
Agron Bajraktari	Nënkryetar, Universiteti i Shkencave të Aplikuara në Ferizaj (UShAF)
Hysen Bytyqi	Anëtar, Universiteti i Prishtinës (UP)
Hysen Balaj	Anëtar, Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë (MAShT)
Fisnik Lakna	Anëtar, Ministria e Punës dhe e Mirëqenies Sociale (MPMS)
Menderes Ibra	Anëtar, Ministria e Financave (MF)
Kushtrim Shkodra	Anëtar, Ministria e Shëndetësisë (MSh)
Enver Hajrullahu	Anëtar, Ministria e Tregtisë dhe Industrisë (MTI)
Besim Mustafa	Anëtar, Oda Ekonomike (OE)
Bekim Hasani	Anëtar, QSE "Don Bosko"
Arian Zeka	Anëtar, Oda Ekonomike Amerikane (OEA)
Vjollca Xhafa	Anëtare, Agjencia e Përkrahjes së Punësimit në Kosovë (APPK)
Mehreme Llumnica	Anëtare, Handikos

Organogrami i AKK



Stafi menaxhues:

Lah Nitaj	Drejtor
Avni Gashi	Ekspert për sigurim të cilësisë
Bleta Kadriu	Eksperte për standarde
Milot Hasangjekaj	Ekspert për kualifikime
Kaltrina Mulliqi	Eksperte për sigurim të cilësisë
Anita Rukovci	Zyrtare e lartë për monitorim të IAAP
Donjeta Nimani	Asistente administrative

Nga gushti i vitit 2018, Avni Gashi me vendim të Ministrit është emëruar u.d. i drejtorit në Agjencinë e Kosovës për Akreditim (AKA)



Misioni

I themeluar nga Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë në vitin 2009, sipas Ligjit për Kualifikimet Kombëtare (Ligji 03/L-060), Autoriteti Kombëtar i Kualifikimeve (AKK) është organ i pavarur publik, i cili për punën dhe aktivitetet e veta harton raporte pune me qëllim të njoftimit, bashkërendimit dhe llogaridhënies ndaj institucioneve të përcaktuara me ligj.

Sipas ligjit, AKK është përgjegjëse për zhvillimin dhe mbarëvajtjen e Kornizës Kombëtare të Kualifikimeve (KKK) dhe dhënien e kualifikimeve.

Po kështu, AKK e krijon dhe kujdeset për kornizën gjithëpërfshirëse të kualifikimeve si dhe rregullon dhënien e kualifikimeve brenda kornizës.

Funksionimi i Autoritetit mbështet në ligj, udhëzimet administrative dhe Kornizën Kombëtare të Kualifikimeve (KKK). Sipas ligjit, autoriteti ka Këshillin Drejtues prej trembëdhjetë (13) anëtarësh, të aprovuar nga Qeveria e Kosovës, të cilët përfaqësojnë ministritë dhe partnerët social si dhe universitetet. Këshilli takohet së paku gjashtë (6) herë në vit.

Përveç KD, në strukturën e tanishme organizative (organogramin) autoriteti ka; Drejtorin, Sektorin e sigurimit të cilësisë, Sektorin e kualifikimeve, Sektorin për standarde, Sektorin për monitorim dhe zyrën administrative. Për realizimin e funksionit dhe obligimeve, punëve dhe detyrave në AKK janë të punësuar gjithsej shtatë veta.

AKK-ja ka përgjegjësi në përcaktimin e niveleve të kualifikimeve në Kornizën Kombëtare të Kualifikimeve, harmonizimin e niveleve të kualifikimeve me Kornizën Evropiane të Kualifikimeve (KEK), caktimin e kritereve për aprovimin e kualifikimeve dhe akreditimin e Institucioneve të Arsimit dhe Aftësimit Profesional (AAP), përfshirjen e kualifikimeve të aprovuara në KKK, lehtësimin e progresit dhe transferit ndërmjet formave të ndryshme të të mësuarit dhe sigurimin e cilësisë në institucionet e akredituara të AAP-së.



Synimet dhe objektivat

Ndër synimet parësore të AKK-së është mbikëqyrja dhe zhvillimi i Kornizës Kombëtare të Kualifikimeve (KKK) në kontekst të të mësuarit gjatë gjithë jetës, në partneritet me nxënës/kandidat, punëdhënës dhe ofrues të arsimit dhe aftësimit në nivelin parauniversitar dhe në përputhshmëri me nevojat dhe kërkesat e shoqërisë dhe ekonomisë.

Vizioni i AKK-së është krijimi i një sistemi cilësor, të besueshëm dhe transparent të kualifikimeve kombëtare, me qëllim të rritjes së mundësive për mobilitet kombëtar dhe ndërkombëtar.

Për ta arritur këtë, AKK-ja do të:

- aprovoj kualifikime që do të përfshihen në nivelet e caktuara të kornizës dhe të riaprovoj ato sipas nevojës;
- akreditojë, rregullojë dhe monitorojë ofruesit e arsimit dhe aftësimit profesional;
- zbatojë sigurimin e jashtëm të cilësisë së vlerësimeve, që çojnë deri tek dhënia e kualifikimeve në KKK;
- mirëmbajë bazën e të dhënave dhe evidencave të verifikuara dokumentuese të kualifikimeve në KKK dhe certifikatave e diplomave të dhëna;
- bëj rishikime periodike të vlerësimit, si dhe krahasime ndërkombëtare të kualifikimeve;
- bëj këshillimin e institucioneve përgjegjëse për njohjen e kualifikimeve të huaja, për qëllime akademike ose punësimi, përkitazi me çështjet e krahasueshmërisë dhe barasvlerës;
- certifikatat dhe diplomat e dhëna për të gjitha kualifikimet në kornizë miratohen me vulë të autoritetit dhe përfshijnë titullin e aprovuar të kualifikimit, nivelin e tij në KKK dhe informata të tilla varësisht nga kërkesa e AKK-së.

Akterët e rëndësishëm

Për të ushtruar funksionet dhe përgjegjësitë e veta, AKK-ja krijon, zhvillon dhe mirëmban raporte bashkëpunimi dhe konsultimi me të gjithë akterët relevant të KKK, përfshirë:

- Nxënësit/kandidatët
- Mësimdhënësit dhe trajnerët
- Menaxher në shkolla, kolegje dhe universitete
- Koordinatorët për sigurimin e cilësisë
- Punëdhënësit dhe punëtorët
- Institucionet publike dhe private të arsimit dhe aftësimit profesional
- Sindikata dhe shoqata profesionale
- Qeverinë dhe pushtetin lokal
- Agjencitë dhe Këshilla kombëtare, etj.

Konteksti

Sistemi i Arsimit dhe Aftësimit Profesional (AAP), si dhe ai i Arsimit të Lartë (AL) në Kosovë, duhet t'i plotësojë në mënyrë të përshtatshme nevojat e ekonomisë së tregut. Ngritja e cilësisë në sistemin e Arsimit dhe Aftësimit Profesional dhe Arsimit të Lartë, është prioritet i Qeverisë së Kosovës dhe shoqërisë sonë, në mënyrë që shkathtësitë profesionale dhe kompetencat e individëve që përfundojnë AAP-në dhe AL-në të jenë në nivel të kënaqshëm. Mbetet ende sfidë për Kosovën të krijojë një fuqi punëtore të aftë, fleksibile që mund të konkurrojë në tregun vendor, rajonal e më gjerë.

Prandaj, një ndër kriteret kryesore që duhet të plotësojnë kualifikimet për tu aprovuar dhe vendosur në KKK është përputhja e këtyre kualifikimeve me kërkesat e tregut të punës. Ky është ndikimi i drejtpërdrejt i Kornizës Kombëtare të Kualifikimeve në ekonominë tonë. Korniza me kriteret e saj parasheh që institucionet, të cilat dëshirojnë të zhvillojnë një kualifikim, duhet të paraqesin dëshmi se kualifikimi kërkohet në tregun e punës. Si dëshmi mund të përdoren hulumtimet e tregut të punës, konsultimet, rekomandimet e institucioneve qeveritare që zhvillojnë politika zhvillimore si MASHT, KAAP, OEK, MPMS, etj. Gjithashtu, sipas KKK-së kualifikimet e zhvilluara duhet të bazohen në standarde profesionale, të cilat janë bazë për ta arritur këtë.

Standardet profesionale duhet të zhvillohen drejtpërdrejt bazuar në kërkesat e profesionit të caktuar në vendin e punës. Pra, punëdhënësi merr pjesë aktive në këtë proces dhe paraqet kërkesat e nevojshme, të cilat punëtori duhet t'i demonstrojë për kualifikim në fjalë. Kjo është një ndër kriteret e KKK që duhet të plotësohet nga institucionet, të cilat zhvillojnë kualifikime.
AKK ka zhvilluar dhe hartuar udhëzues të shumtë, të cilët do t'i ndihmojnë institucionet e arsimit dhe aftësimit profesionale t'i përmbushin këto kritere dhe të jenë pjesë e Kornizës Kombëtare të Kualifikimeve.

Planifikimi

Për të ushtruar funksionet dhe përgjegjësitë e veta, AKK-ja krijon, zhvillon dhe mirëmban raporte bashkëpunimi dhe konsultimi me të gjithë akterët relevant të KKK, përfshirë:



Pamje nga mbledhja e Këshillit Drejtues të Autoritetit Kombëtar të Kualifikimeve

AKK zhvillon politika dhe strategji për krijimin dhe zbatimin e Sistemit Kombëtar të Kualifikimeve në pajtueshmëri me Ligjin për Kualifikimet Kombëtare.

Bazuar në objektivat strategjike të AKK-së, ne hartojmë "Planin e punës" së AKK-së duke i përcaktuar prioritetet dhe aktivitetet vjetore. Stafi menaxhues është përgjegjës për zbatimin e detyrave dhe aktiviteteve të përcaktuara, ndërsa në takimet e KD vlerësohet realizimi i aktiviteteve sipas planit.

AKK-ja paraqet raportin mbi progresin e aktiviteteve të veta tek MASHT-i, Zyra e Kryeministrit dhe ministritë relevante, çdo gjashtë muaj, ndërsa raportin vjetor e parashtron në Qeverinë e Kosovës. Raportet publikohen në webfaqe të AKK-së.





Pamje nga takimet e Këshillit Drejtues

Plani i punës 2018

KD i AKK-së në fillim të vitit miratoi "Planin e punës" për vitin 2018. Synimet themelore sipas planit për këtë vit janë:

1. Vazhdimin e validimit dhe akreditimit të institucioneve publike dhe private të Arsimit dhe Aftësimit Profesional;
2. Popullimin e KKK me aprovimin e kualifikimeve pas procesit të validimit;
3. Sigurimin e cilësisë së programeve dhe aktiviteteve në shkollat profesionale publike
4. Të zbatoj procesin e monitorimit të institucioneve pas akreditimit;
5. Të zbatoj implementimin e njohjes së mësimit paraprak (NjMP) në sistemin arsimor të Kosovës;
6. Zbatimin e strategjisë ndërvepruese të komunikimit që siguron efikasitet më të madh në procesin e validimit, akreditimit dhe sigurimin e cilësisë;
7. Konsultim gjithëpërfshirës me akterët relevantë të KKK në funksion të përmbushjes së kërkesave të tregut dhe institucioneve që ofrojnë arsimim dhe aftësim profesional;
8. Rishikimi i KKK në harmoni me kërkesat e kohës dhe interesat strategjike në fushën e arsimit dhe aftësimit profesional në vendin tonë;
9. Sensibilizimin e të rinjve, grupeve të interesit, publikut dhe institucioneve relevante për rolin dhe misionin e AKK lidhur me llojet dhe nivelet e kualifikimeve dhe certifikimeve në fushën arsimit dhe aftësimit profesional;
10. Certifikimin e rezultateve të mësimit joformal dhe informal, përfshirë njohjen e mësimit paraprak dhe arritjet e kandidatëve;
11. Në planin legjislativ hartimi i Udhëzimeve Administrative (UA) të nevojshme dhe plotësim i atyre ekzistuese në raport me zhvillimet e nevojshme;
12. Thellimi dhe zgjerimi i bashkëpunimit me institucionet e vendit dhe partnerët zhvillimor ndërkombëtar;
13. Pjesëmarrje në projektet e BE-së dhe aktivitete ndërkombëtare në funksion të zhvillimit të vazhdueshëm dhe ngritjes profesionale të AKK-së (ndërlidhja zyrtare e Kornizës Kombëtare me të Kualifikimeve (KKK) me Kornizën Evropiane të Kualifikimeve (KEK);
14. Plani i punës për vitin 2018, është në webfaqen e AKK: **https://akkks.rks-gov.net/**

Raporti i punës 2018

Ky raport është një përmbledhje e aktiviteteve dhe objektivave të realizuara të Autoritetit Kombëtar të Kualifikimeve gjatë vitit 2018 në përputhje me planin e punës për këtë vit dhe në përputhje me Ligjin për Kualifikimet Kombëtare. Raporti është hartuar nga Autoriteti Kombëtar i Kualifikimeve dhe miratuar nga Këshilli Drejtues i AKK-së.

Struktura e raportit i përmbahet organikës strukturale të Autoritetit dhe prezanton punët e bëra, rezultatet e arritura dhe sfidat që e kanë përcjellë gjatë periudhës raportuese.

Aktivitetet e realizuara

Standardet e profesionit

Në realizim të "Planit të punës" Autoriteti Kombëtar i Kualifikimeve (AKK) gjatë vitit 2018, ka proceduar pesëmbëdhjetë (15) procese të verifikimit të standardeve të profesionit, gjë që ka rezultuar me rritjen e numrit të standardeve të aprovuara në nivel vendi për 13 sosh, kurse dy tjera nuk janë aprovuar për shkak të mangësive dhe mos përmbushjes së kritereve të nevojshme.

Për realizimin e këtyre proceseve janë angazhuar një numër i konsideruar i stafit profesional (ekspertë të jashtëm) sipas procedurave ligjore.

Standardet e profesionit janë zhvilluar nga institucione dhe partnerë të ndryshëm: Asociacioni Kosovar i Motorizmit, Shoqata Netrda, Bau Academy, Projekti ALLED, Oda Ekonomike e Kosovës, Këshilli i Konsulentëve të Biznesit (BCC), Kolegji i Shkencave të Aplikuara Teknike (Tempulli), Qendra për Zhvillim Profesional (QZHP) dhe shoqata të ndryshme, etj.



Pamje nga takimet për Standarde të Profesionit

Në vitin 2018 ka përfunduar procesi i verifikimit për këto standarde të profesionit:

Sektori i komunikacionit

- Instruktor i shoferëve (niveli 5 i Kornizës kombëtare të kualifikimeve)

Sektori për prodhim dhe përpunim të ushqimit

- Kultivues i perimeve/kultivuese e perimeve (niveli 2)
- Konservuesit e frutave, perimeve dhe të ngjashme (niveli 4)
- Punëtorët e të mbjellave (niveli 2)

Sektori i turizmit:

- Agjent/agjente turistike dhe i informimit për udhëtimet (niveli 4)

Sektori i arsimit

- Punëtorët e prodhimit-Paketuesit me dorë (niveli 3)

Sektori i bujqësisë

- Vreshtar/vreshtarë (niveli 3)

Sektori i shërbimeve

- Rrobaqepësit/rrobaqepëset, kapelabërësit (niveli 3)
- Modelist prerës dhe punues të tekstilit dhe të tjerë të ngjashëm (niveli 4)

Sektori i transportit

- Muratorët dhe punëtorët e ngjashëm (niveli 4)
- Operuesit e kamionëve të ngritjes (niveli 3)
- Operuesit e impianteve të lëvizjes së dheut dhe të ngjashëm (niveli3)
- Shoferët e makinave, taksive dhe furgonave (niveli 4)

Nuk janë miratuar këto SP edhe pse janë verifikuar:

Sektori i transportit

-Operuesit e impianteve të vinçave, ngritjes dhe të ngjashëm.

Sektori i teknologjisë ushqimore

-Asistent i Nutricionizmit dhe sigurisë së ushqimit

Në sektorin i dizajnit janë në proces të verifikimit standardet; Teknik dizajnerë dhe dekoratorë të interierit me produkte drusore dhe nga Sektori i përpunimit të drurit, Përpunues i drurit- "Zdrukthëtarë".

Po kështu, Këshilli Drejtues ka miratuar fillimin e procesit të verifikimit për standardet e profesionit:

Siguri Publike

-Instruktor në vendin e punës
-Instruktor/ mësimdhënës për të rritur
-Trajner në kompani

Sektori i ndërtimtarisë

-Shtruesit e dyshemeve dhe punëtorët për vendosjen e pllakave
-Instaluesit e ngrohjes qendrore
-Hidraulikët dhe montuesit e tubave

Sektori i elektroteknikë

- Teknikët e inxhinierisë elektrike
- Mekanikët e montuesit elektrike

Sektori Shërbime

-Vlerësues i pronave të paluajtshme



Pamje nga takimet për Standarde të Profesionit

Rregullimi i Kornizës Kombëtare të Kualifikimeve (KKK)

KD i AKK-së në fillim të vitit miratoi "Planin e punës" për vitin 2018. Synimet themelore sipas planit për këtë vit janë:

KKK-ja është e rregulluar përmes mekanizmave që synojnë të sigurojnë përputhje me aranzhimet dhe kërkesat e përcaktuara për sistemin e kualifikimeve, dhe për të siguruar se sistemi ofron kualifikime me cilësi të pranueshme.

Tashmë janë rregulluar të gjithë mekanizmat për arritjen e këtyre objektivave:

- Validimi dhe aprovimi i kualifikimeve të propozuara për përfshirje në KKK;
- Akreditimi i institucioneve përgjegjëse për vlerësimin dhe certifikimin e kualifikimeve të miratuara të KKK-së;
- Sigurimi i cilësisë së institucioneve të akredituara dhe ofrimi i kualifikimeve të validuara;
- Sistemi i kredive;
- Njohja e mësimit paraprak





Autoriteti Kombëtar i Kualifikimeve për të planifikuar, organizuar dhe zbatuar sa më mirë rregullimin e KKK-së ka mbajtur mbi 50 takime në zyrat e veta që kryesisht kishin të bëjnë me:

- Rishikimin dhe adaptimin e planit të punës;
- Përgatitjen për procesin e validimit dhe akreditimit;
- Përgatitjen e certifikatave dhe vendimeve për akreditim;
- Hartimin e konkurseve për panele të ekspertëve të jashtëm dhe botimit të tyre në gazetat ditore;
- Përgatitjen e listës së ngushtë, intervistimin dhe përzgjedhjen e ekspertëve të jashtëm;
- Përgatitjen e planeve për aktivitetet e SC-së të mbështetura nga Këshilli Britanik;
- Organizimin e konferencave për shtyp;
- Planifikimin dhe organizimin e punëtorive për sigurim të cilësisë;
- Planifikimin dhe organizimin e punëtorive për monitorim;
- Mbështetjen për takimet e Këshillit Drejtues të AAK-së;
- Mbajtjen e takimeve të rregullta me zyrtarët e MASHT-it;
- Organizimin e vizitave në institucione, për ekipet e ekspertëve; të jashtëm për validim dhe akreditim, riakreditim, rishikim dhe monitorim etj.
- Vazhdimi i zhvillimit të softuerit për procesin e aplikimit online dhe monitorim të IAAP.



Gjykuar në nevojën për ngritje të cilësisë, nevojën për ndërtim të kapaciteteve, bashkërendim dhe koordinim ndërinstitucional, si dhe transmetimit të informacioneve të rëndësishme lidhur me sfidat në fushën e arsimit profesional dhe angazhimet e mëtejme, në fillim të vitit 2018 janë mbajtur punëtori të ndryshme për "Azhurnimin dhe rishikimin e Kornizës Kombëtare të Kualifikimeve".

Në punëtoritë rreth këtyre çështje u shtjelluan zhvillimet dhe reflektimet e gjendjes aktuale të sistemit të kualifikimeve në Kosovë, ndryshimet e mundshme dhe përshtatja praktike e dokumentit që të jetë brenda kornizave ligjore, reflektim i sistemit aktual dhe kuptimit më të plotë nga palët tjera.

Validimi i kualifikimeve në KKK dhe akreditimi i Institucioneve të Arsimit dhe Aftësimit Profesional

Bazuar në planin e punës gjatë vitit 2018, AKK ka organizuar dhe ka marrë pjesë në të gjitha aktivitetet që kanë të bëjnë me validimin dhe akreditimin e ofruesve të AAP-së, vlerësimin dhe vizitat e ekspertëve në institucionet përkatëse, shikimin e kushteve dhe kritereve, dokumentacionit, hapësirave dhe pajisjeve për punë, stafin arsimor e trajnues dhe aspektet tjera të rëndësishme.
Për këtë qëllim, veç stafit të AKK janë angazhuar edhe ekspertë të jashtëm sipas fushave përkatëse.
Në funksion të njësimit të procedurave dhe kredibilitetit të procesit, janë organizuar takime me të gjithë ekspertët e fushave përkatëse paraprakisht. Takimet kanë qëllim informues lidhur me procesin e validimit dhe akreditimit të institucioneve të interesuara dhe dinamikën e procesit dhe transparencën.
Në vitin 2018, nga stafi i AKK dhe ekspertët janë realizuar procedurat standarde për institucionet aplikuese:

- Shqyrtimi i aplikacioneve
- Vizita në institucione
- Hartimi i raporteve të vlerësimit për validim të kualifikimit dhe akreditim të institucioneve

Janë akredituar 12 institucione të Arsimit dhe Aftësimit Profesional me 45 profile të ndryshme, është bërë rishikimi i kushteve i pesë (5) ofruesve të akredituar me kusht për 21 profile, janë riakredituar tri (3) institucione si dhe janë monitoruar katër (4) institucione me 10 profile

Vizitat në institucione

Gjatë vizitave në institucione panelet kanë takuar menaxherët e institucioneve, zyrtarët për sigurim të cilësisë dhe mësimdhënësit/trajnerët e profileve përkatëse, nxënësit ose pjesëmarrësit e trajnimeve, ndërsa janë vizituar shumë punëtori dhe institucione, në të cilat këta kandidatë janë duke e kryer pjesën praktike.

Fillimisht, gjatë vizitës u zbatua verifikimi i gjendjes, dëshmive dhe materialeve sipas aplikacionit për validim të kualifikimeve. Sipas procedurave për validimin e kualifikimit u verifikuan këto pika:

- Modulet;
- Struktura e kualifikimit;
- Numri i kredive;
- Qëllimi dhe përmbajta e kualifikimit/modulit;
- Niveli i kualifikimit/modulit në KKK;
- Pjesa teorike dhe praktike;
- Standardet profesionale;
- Njohja e mësimit paraprak;
- Mënyra dhe kriteret e vlerësimit;
- Literatura

Poashtu, gjatë vizitës, sipas aplikacionit për akreditimin e institucioneve, është bërë verifikimi i gjendjes, dëshmive, infrastrukturës dhe materialeve, duke përfshirë këto pika:

- Pajisjet dhe mjetet për praktikë;
- Kabinetet dhe punëtoritë;
- Gjendjen financiare;
- Stafin dhe menaxhmentin;
- Kriteret dhe politikat për vlerësimin e kandidatëve me nevoja të veçanta;
- Qasjen e barabartë për kandidatë;
- Sigurinë dhe shëndetin;
- Certifikimin;
- Bazën e të dhënave

Gjatë këtij procesi, u vlerësua përshtatshmëria e objektit me kualifikimin e ofruar, infrastruktura për kandidatë me nevoja të veçanta, siguria dhe çështje tjera me interes.





Pamje nga vizitat gjatë procesit të validimit dhe akreditimit

Përpilimi i raportit të vlerësimit për validim dhe akreditim

Në kuadër të këtij procesi, panelet përkatëse përpiluan draft raportet për validimin dhe akreditimin për kualifikimet përkatëse të institucioneve aplikuese. Raportet u krijuan duke u bazuar në dokumentet, materialet dhe dëshmitë e ofruara, përfshirë edhe vizitat në institucione, si dhe dëshmitë shtesë dhe informatat kthyese nga institucionet përkatëse.

Raportet janë pasqyrim i gjendjes së ofruesit dhe vlerësimi i panelit është bazuar konform kritereve të Udhëzimit Administrativ të nxjerrë nga Ligji për Kualifikime Kombëtare. Të gjitha draft raportet janë kthyer në institucione për ta bërë vlerësimin brenda afatit kohor të përcaktuar sipas procedurave të UA. Pas kësaj procedure raportet finale janë dërguar në KD të AKK-së me rekomandime për aprovim apo mos aprovim.



Pamje nga takimet e Këshillit Drejtues të AKK

Duhet theksuar se i tërë ky proces gjatë vitit 2018, pa marrë parasysh vështirësitë dhe numrin e kufizuar të stafit që ka AKK-ja, përkundër kësaj, procesi ka rrjedhur jashtëzakonisht mirë dhe në frymën bashkëpunimit shumë të ngushtë me institucionet aplikuese dhe palët me interes të përfshira në proces.

Puna e Autoritetit, ka rezultuar me validimin dhe regjistrimin e këtyre kualifikimeve në KKK:

- Ekspert tatimor
-Ekspertë i lartë tatimor
- Ekspert i licencuar i forenzetikës financiare
- Profesionistët/specialistët e administrimit të softwerit
- Trajnerët, instruktorët dhe zyrtarët sportiv
- Instruktorët e shoferëve
- Modelist, Prerës dhe punues të tekstilit dhe të tjerë
- Rrobaqepës, prerës dhe punues të tekstilit dhe të tjerë të ngjashëm
- Shitja dhe shërbimi i klientit
- Polic i ri
- Inspektor i Inspektoratit Policor të Kosovës
- Zyrtar doganor
- Zyrtar korrektues
- Zyrtar s provues
- Referent/Referente (nëpunës/e) i/e kuadrove
- Nëpunës i marketingut
- Asistent i shitjes
- Teknik i zhvillimit të softuerit

Gjatë vitit 2018 u akreditуan këto institucione:

Telekomi i Kosovës – Qendra për Trajnim dhe Zhvillim (QTZH)

- Shitja dhe shërbimi i klientit

Shoqata e Kontabilistëve të Certifikuar dhe auditorëve të Kosovës - SHKCAK

- Ekspert tatimor
- Ekspert i lartë tatimor
- Ekspert i licencuar forenzikës financiare

Coiffure school

- Parukeri

Qendra e bukurisë Camellias

- Manikyr

Akademia për siguri publike e Kosovës – (ASKP)

- Polic i ri
- Inspektor i Inspektoratit policor të Kosovës
- Zyrtar doganor
- Zyrtar korrektues
- Zyrtar s provues

RIT KOSOVO - AUK

- Profesionistët/Specialistët e Administrimit të Politikave

Kolegji Tempulli

- Instruktorët e shoferëve

Shoqata e bizneseve për edukimin dhe trajnimin e përdorimit të armëve të zjarrit civile dhe sportive në "i 2 Defense")

- Trajnerët, instruktorët e shoferëve
- Zyrtarët sportiv

Kolegji Evropian i Kosovës

- Shitja dhe shërbimi i klientit
- Teknik i zhvillimit të softuerit

UNI BB me kualifikimet:

- Modelist, Prerës dhe punues të tekstilit dhe të tjerë të ngjashëm
- Rrobaqepës, prerës dhe punues të tekstilit dhe të tjerë të ngjashëm

Prime Education

- Referent/Referente (nëpunës/e) i/e kuadrove
- Nënpunës i marketingut
- Asistent i shitjes

IBC Nails

- Manikyr
- Pedikyr

Rishikimi i kushteve në vitin 2018 është bërë në (5) institucione me kusht me 22 profile:

Oxford Studio (Prishtinë, Gjilan, Prizren, Istog dhe në Gurrakoc)

- Gjuhë anlgeze

Bau Academy

- Instalues elektrik
- Metalpunues
- Instalues i ujësjellësit dhe kanalizimit
- Instalues i ngrohjes qendrore dhe klimatizimit

American Beauty School

- Manikyr

Illusion Academy

- Parukeri
- Grim dhe Manikyr (për plotësim të kushteve është dhënë afati deri më 28 shkurt 2019)

AAB/Shkolla Profesionale Gjermane

- Furnitor
- Asistent Administrativ
- Specialist i Sigurisë Kibernetike
- Shitës
- Oficer doganor
- Niveli
- Estetikë,
- Grimer
- Parukeri
- Trafik rrugor
- Transport rrugor
- Programer profesionit
- Adminstrues i rrjetit dhe sigurisë së sistemeve





Pamje nga vizita për rishikim të kushteve në Shkollen Profesionale Gjermane



Pamje nga pjesëmarrja në vizita në institucione të akredituara për rishikimin e kushteve

Rishikimi i kushteve në vitin 2018 është bërë në (5) institucione me kusht me 22 profile:

Telekomi i Kosovës - Qendra për Trajnim dhe Zhvillim

- Gjuhë angleze

Infinit Qatar Center

- Gjuhë angleze

Diakonie Traning Center – DTC

- Instalues i ujësjellësit dhe kanalizimit
- Instalues i ngrohjes qendrore
- Instalues elektrik



Pamje nga vizita për akreditim



Pamje nga vizita në punëtoritë e IAAP

Sektori i monitorimit

Autoriteti Kombëtar i Kualifikimeve, sipas dinamikës së ndjekur, ka zhvilluar mekanizmat për procesin e funksionalizimit të zbatimit të procesit të monitorimit në Institucionet e Arsimit dhe Aftësimit Profesional (IAAP) pas akreditimit, në mënyrë që ta monitoroj në mënyrë efektive performancën e tyre, me qëllim të konstatimit të përmbushjes së kritereve të validimit dhe akreditimit. Zbatimi i monitorimit është i përcaktuar me Ligjin nr. 03/L-060 mbi Kualifikimet Kombëtare.

Gjatë vitit 2018, sektori i monitorimit ka organizuar punëtori për procesin e monitorimit të IAAP pas akreditimit sipas dokumentit të zhvilluar nga projekti ALLED. Në to janë finalizuar udhëzuesit për monitorim, formularët për raportim të monitorimit; sigurimin e cilësisë/monitorimin dhe rishikimin e raportit të vetëvlerësimit (RVV) nga ofruesit, planin për përmirësim si dhe monitorimin dhe rishikimin e kualifikimeve dhe moduleve të validuara.



Pamje nga procesi i punëtorive për procesin e monitorimit

Udhëzuesit do ta ndihmojnë AKK që ta monitorojë në mënyrë efektive përformancën e IAAP, me qëllim të konstatimit të përmbushjes së kritereve të validimit dhe akreditimit. Në kuadër të monitorimit hyjnë të gjitha elementet që kanë të bëjnë me funksionimin e institucioneve përkatëse, përfshirë; vlerësimin, certifikim e kandidatëve, llojin e kualifikimeve-moduleve të validuara, raportin e vetëvlerësimit dhe planin e përmirësimit.

Ky sektor ka zhvilluar edhe aktivitete lidhur me procesin e monitorimit të IAAP, përfshirë edhe vizitat e ekspertëve të fushave në institucione.

Janë monitoruar këto institucione:

- DBBS në Prizren
- KAS me qendrat në Ferizaj, Prishtinë, Gjilan dhe Kamenicë
- Dituria në Prizren dhe
- American Beauty School me qendrat në Ferizaj dhe Gjilan.



Pamje nga procesi i vizitës monitoruese në Institucionin American Beauty School, Ferizaj

Për mosplotësim të kushteve të caktuara nga rekomandimet e raporteve të ekspertëve dhe nga Këshilli Drejtues, u është tërheqë akreditimi këtyre institucioneve:

DBBS SH.P.K (Prizren)

- Metalpunues
- Instalues elektrik
- Instalues i ujësjellësit dhe kanalizimit dhe
- Instalues i ngrohjes qendrore

Qendra e bukurisë KAS (Ferizaj, Gjilan, Kamenicë dhe Prishtinë):

- Parukeri
- Grim
- Manikyr
- Pedikyr



Pamje nva vizitat monitoruese në Institucionet e AAP

Ndërsa, nga vizita monitoruese në American Beauty School, me qendrat në Ferizaj dhe Gjilan për profilet Parukeri dhe grim, rezultoi se kjo qendër është duke funksionuar sipas standardeve të kërkuara në përputhje me kriteret për sigurim të cilësisë.

Promovimi i KKK-së dhe AKK-së

AKK-ja ka zhvilluar dhe zbatuar strategji të vazhdueshme të komunikimit për të mbajtur të informuar të gjitha palët e interesit, duke përfshirë këtu edhe publikun e gjerë. Kjo është bërë nëpërmjet aktiviteteve dhe mjeteve të ndryshme, si në vijim:

- Mbajtja e takimeve e rregullta me palët e interesit (ofruesve publik, ata privat dhe të të gjithë Institucioneve të Arsimit dhe Aftësimit Profesional;
- Organizimi i konferencave, punëtorive informuese për KKK-së/seminare për grupe të ndryshme nga sektorit publik dhe privat;
- Organizimin e ceremonisë për shpërndarjen e certifikatave për institucionet ofruese nga procesi i validimit dhe akreditimit;
- Pjesëmarrje në konferenca lokale, rajonale dhe vizita studimore;
- Pjesëmarrja në media elektronike dhe të shkruara;
- Botimi i materialeve promovuese për audiencën e përgjithshme dhe audiencën e synuar;
- Mirëmbajtja dhe përditësimi i uebfaqes;
- Editimi dhe shpërndarja e publikimeve të ndryshme,
- Popullimi i informatave në softuer etj.



Pamje nga punëtoritë e Autoritetit Kombëtar të Kualifikimeve

Organizimi i konferencave, punëtorive dhe seminareve

Gjatë vitit 2018 janë mbajte punëtori për "Rishikimin, plotësimin dhe popullimin e Kornizës Kombëtare të Kualifikimeve". Në to janë shtjelluar zhvillimet dhe reflektimet e gjendjes aktuale të sistemit të kualifikimeve në Kosovë, ndryshimet e mundshme dhe përshtatja praktike e dokumentit brenda kornizave ligjore, si dhe reflektimi i sistemit aktual dhe sqarimi më i plotë i KKK për institucionet dhe palët e interesit.

Gjatë vitit janë rishikuar, përshtatur dhe adoptuar formularët e validimit dhe akreditimit si dhe format e rishikimit të raporteve vlerësuese. Tashmë, këto forma dhe dokumente janë thjeshtëzuar dhe bërë mjaft praktike për të gjitha institucionet që ofrojnë Arsim dhe aftësim profesional.



Pamje nga punëtoria për rishikimin e formularëve për validim dhe akreditim

AKK ka vazhduar bashkëpunimin e suksesshëm me Fondacionin Evropian të Trajnimeve (ETF), dhe janë organizuar aktiviteteve të ndryshme për zgjerim të bashkëpunimit. Do të veçonim pjesëmarrjen në seminarin e përbashkët të 3 shteteve: Kosovë, Shqipëri dhe Maqedoni të organizuar nga ETF në Tiranë. Kjo ishte një mundësi e mirë për shkëmbim të përvojave dhe eksperiencave të ndërsjella, me synim ngritjen e kapaciteteve për zbatim të Njohjes së Mësimit Paraprak (NjMP).

Me këtë rast janë hartuar dy draft versionet e para të akteve nënligjore, një draft për Shqipërinë dhe Maqedoninë, dhe drafti për procedurat lidhur me akreditimin e ofruesve të (NjMP) për Kosovë.

Në mbështetje të "DVV Internacional" në Kosovë, kemi vazhduar aktivitetet rreth krijimit të mekanizmave për (NJMP). Ndërlidhur me këtë është realizuar punëtori me grupin e punës për zhvillimin e draftit të parë Udhëzimit Administrativ të NJMP.





Pamje nga punëtoritë për procesin e Njohjes së Mësimit Paraprak

Kemi zhvilluar procesin e pilotimit për aplikim për NJMP. Institucionet e përfshira në këtë proces kanë qenë; Qendra Rajonale e Aftësimeve Profesionale (QRAP) Gjilan dhe Korporata Elektroenergjitike e Kosovës (KEK), të cilat kanë aplikuar sipas UA, me ç'rast është testuar funksionaliteti i tyre.

Në kuadër të aktiviteteve për zbatimin e procesit për NJMP, është organizuar punëtori informuese për prezantimin e udhëzuesit për, Mentorët dhe Vlerësuesit e Njohjes së Mësimit Praprak. Në këtë punëtori pjesëmarrësit u informuan për detyrat dhe kompetencat e tyre sa i përket zbatimit të NJMP-së, pra koordinatorë, mentor dhe vlerësues të NJMP.





Pamje nga punëtoria për prezantimin e udhëzuesit për Mentorët dhe Vlerësuesit e NJMP-së

Kemi marrë pjesë në aktivitetin e organizuar nga Ambasada Austriake-pjesë e zhvillimit të dokumenteve të veprimit ALLED II, ku janë prezantuar akterët relevant ndërkombëtar dhe janë trajtuar temat e referencës për projektin e ri nga ALLED. Në fokus të interesimit në ketë projekt janë shkollat profesionale dhe KKK, si dhe mbështetja që mund ta ofroj ALLED për zhvillimin e kapaciteteve të këtyre shkollave sipas KKK.

Gjatë vitit kemi bashkëpunuar dhe marr pjesë në të gjitha aktivitetet e organizuara nga MAShT, që nga rregullorja për mësimdhënies në nivelin e 5, vlerësimi i këtij niveli, sigurimi i cilësisë, takimet me kabinetin e ministrit lidhur me fillimin e procesit akreditues për shkollat profesionale publike, konferencën vjetore për realizimin e PSAK, etj.

Kemi marr pjesë në Komitetin Drejtues të ngritur për hartimin e dy Standardeve profesionale në sektorin e Bujqësisë në nivelin e tretë të KKK "Punëtor për mbledhje, kultivim dhe procesim të bimëve mjekësore" dhe "Punëtor për mbledhje, kultivim dhe prcesim të frutave të malit" në kuadër të projektit ndërkufitar Shqipëri-Kosovë të financuar nga BE, SWEI (Skilled Workforce for Economic Integration).

Kemi kontribuar në takimet dhe diskutimin e organizuar nga MASHT, në kuadër të projektit EYE, lidhur me standardet e profesionit, validimin e kualifikimeve dhe akreditimin e institucioneve të AAP në Kosovë.

Lidhur me standardet e profesionit përfaqësues nga AKK, Agjencia për Arsimin dhe Formimin Profesional të Shqipërisë, Agjencia e Punësimit të Kosovës, ekspertë të fushave për dy standardet e profesionit, kanë kontribuar në finalizimin e standardeve të profesionit, Punëtor për mbledhje, kultivim dhe procesim të frutave të malit dhe Punëtor për mbledhje, kultivim dhe procesim të bimëve mjekësore/aromatike", në takimin e dytë brenda vitit 2018.





Pamje nga punëtoria për Standarde të Profesionit e mbajtur në Shqipëri

Po kështu, pjesëmarrës kemi qenë në tryezën e punës të organizuar nga Ministria e Administratës Publike, gjegjësisht, Instituti i Kosovës për Administratë Publike (IKAP) në bashkëpunim me Ambasadën e Francës dhe Shkollën për Administratë Publike të Francës (ENA) për zyrtarët e nivelit të lartë drejtues, në temën "Etika dhe Integriteti në Administratën Publike-Korniza Evropiane".

Botimi i materialeve

Autoriteti Kombëtar i Kualifikimeve ka qenë shumë i angazhuar në dizajnimin, publikimin dhe shpërndarjen e një sasie të konsiderueshme të dokumenteve të prodhuara nga AKK-ja.

Dokumentet kryesore janë publikuar në formë të shtypur, me dizajn dhe shenjë adekuate, në gjuhën: shqipe, serbe dhe angleze dhe u janë shpërndarë institucioneve të ndryshme të AAP-së dhe institucioneve tjera që ofrojnë Trajnime, Arsim dhe Aftësim Profesional, si dhe palëve me interes në këtë fushë, përfshirë edhe institucionet partnere jashtë vendit.

Këto publikime përfshijnë:

1. Udhëzuesi për Koordinatorë, Mentorë dhe Vlerësues të Njohjes së Mësimi Paraprak,

2. Raportin vjetor të vitit 2018

CIKLI I CILËSISË

i Kornizës Kombëtare për Sigurim të cilësisë për AAP në Kosovë

1.
Qëllime të qarta, të përshtatshme dhe të matshme, objektiva të qarta në aspektin e politikave, procedurave, detyrave, resurseve njerëzore, në udhëheqje, planifikim të strategjive, partneritet dhe financa.

2.
Krijimi i procedurave për të siguruar arritjen e qëllimeve dhe objektivave, zhvillimi i partneriteteve, përfshirja e akterëve, menaxhimi i resurseve njerëzore / fizike, alokimi i mjeteve dhe procedurat organizative dhe operative.



3.
Hartimi i mekanizmave për vlerësimin e arritjeve dhe rezultateve, mbledhjen dhe përpunimin e të dhënave në mënyrë që të arrihen informata të sakta rreth proceseve të vlerësimeve, stafit dhe rezultatet të tjera të tregut të punës.

4.
Zhvillimi i procedurave për të arritur rezultatet e synuara dhe / ose objektiva të reja, pas përpunimit të informatave kthyese. Planifikim dhe implementim i veprimeve për përmirësim dhe verifikim të jashtëm.

PRINCIPET E CILËSISË

PRINCIPI I CILËSISË 1 - Qëllimi dhe plani: Përgjegjësitë e menaxhmentit

- Lidershipi
- Financat
- Partneriteti
- Sistemi për informim
- Strategjitë, Politikat dhe Procedurat
- Menaxhimi i cilësisë

PRINCIPI I CILËSISË 2 - Qëllimi dhe Plani: Menaxhimi i resurseve

- Burimet fizike
- Burimet njerëzore

PRINCIPI I CILËSISË 3 - Qëllimi dhe Plani: Dizajni dhe zhvillimi

- Zhvillimi i programit mësimor
- Rishikimi i programit mësimor

PRINCIPI CILËSISË 4 - Implementimi: Mësimi, Vlerësimi dhe Certifikimi

- Rekrutimi i nxënësve
- Shërbimi përkrahës
- Mësimdhënia në klasë dhe trajnimi praktik
- Vlerësimi Përmbledhës
- Certifikimi

PRINCIPI I CILËSISË 5 - Vlerësimi dhe verifikimi; Procesi i vetë-vlerësimit

- Grumbullimi i informatave kthyese
- Pajtueshmëria me procedurat
- Monitorimi i performacës
- Raporti për vet-vlerësim

PRINCIPI I CILËSISË 6 - Informatat kthyese dhe ndryshimet: Procesi i përmirësimit

-Ofrimi i informatave kthyese
-Planet e përmirësimit

AKK-ja, po ashtu ka publikuar fletushkën informative që përmban informata mbi rolin e saj në raport me KKK-në, kualifikimet e aprovuara në të, ofruesit e AAP-së të akreditуar nga AKK-ja, si dhe përfitimet e individit, partnerëve social dhe ofrueseve të AAP-së nga zbatimi i KKK-së. Fletushka është shpërndarë gjatë takimeve dhe ngjarjeve të organizuara nga Autoriteti si dhe palëve tjera të interesit.

Prezantimi në media elektronike dhe të shkruara

Për të ndihmuar vetëdijesimin e publikut të gjerë, është zhvilluar një fushatë me pjesëmarrjen e menaxhmentit të Autoritetit në emisione të caktuara televizive.

Drejtuesit e AKK-së kanë marrë pjesë në numër të programeve televizive dhe të radios, në të cilat është diskutuar roli i AKK-së, funksioni dhe objektivat e KKK-së, mekanizmat e zhvilluara nga KKK-ja për zbatimin e saj, si dhe përfitimet e individit nga zbatimi i KKK-së.

Artikuj të ndryshëm mbi aktivitet e AKK-së u publikuan në këto mediume: Kosova Sot, Koha Ditore, Epoka e re, etj.

Mirëmbajtja dhe përditësimi i uebfaqes

Uebfaqja e AKK-së i përmbahet kritereve të përcaktuara me Ligjin nr. 03/L-215, për Qasje në dokumente publike. Është në tri gjuhë dhe përmban informata themelore për AKK-në dhe KKK-në, ligjet dhe udhëzimet përkatëse, dokumente dhe publikime, të cilat janë me interes për publikun dhe në funksion të transparencës.

Uebfaqja, gjithashtu përmban materialet e publikuara, në mënyrë që të mund t'iu ofrohen të gjitha palëve të interesuara, dokumentet në format elektronik. Në të është publikuar edhe lista e institucioneve të akredituara. Uebfaqja është pasuruar me linqe dhe vegëza të reja që ofrojnë mundësi më të mirë kërkimi, si dhe ndërlidhje shtesë me uebfaqet përkatëse.

Në uebfaqe e AKK janë vendosur edhe video dhe audio incizimet që janë përdorur në fushatën e mediale për të siguruar qëndrueshmëri të vazhdueshme të mesazheve të promovuara.

Bashkëpunimi ndërkombëtar

Edhe në vitin 2018, ka vazhduar bashkëpunimi i suksesshëm me institucione e organizma vendor e ndërkombëtar. Në nivel vendi, e kemi rritur akoma më shumë partneritetin dhe bashkëpunimin me institucionet tona qeveritare, nisur nga MAShT, ZKM, ministritë relevante, partnerët social, grupet e interesit, qytetarët, etj.

AKK ka qenë mjaft aktive në ngjarjet vendore, rajonale dhe evropiane në fushën e kualifikimeve dhe sigurimit të cilësisë.

Po kështu, zyrtarët e AKK kanë marrë pjesë në takimin e organizuara nga ETF së bashku me Ministrinë e Arsimit, në Antalia, përkitazi me sigurimin e cilësisë në AAP.



Pamje nga pjesëmarrja në Forumin Evropian të Trajnimeve për Sigurim të Cilësisë të mbajtur në Vjenë

Zyrtarë të AKK, morën pjesë në konferencën "Ndërtimi i urave në arsimin e të rriturve dhe Simpoziumi i 6 ndërkombëtar andragogjik" në Biograd (Kroaci), ku janë analizuar të arriturat e sistemit në lidhje me arsimin për të rritur në Kosovë, si dhe për zhvillimin e aktivitetet e MAShT në lidhje me kualifikimet e nivelit 5 të KKK.

Zyrtarë të AKK kanë marr pjesë në konferencën e organizuar nga Ambasada amerikane dhe programi KUSA në temën "Arsimi për të ardhmen në Prishtinë", ku janë shkëmbyer informacioneve për zhvillimin e arsimit në vendin tonë, në linjë me nevojat e zhvillimit ekonomik dhe tregut të punës.

Një nga aktivitetet për nivelin e 5 të kualifikimeve ka qenë pjesëmarrja në Torino. Ndërsa, në Bruksel, kemi marr pjesë në takimin e 46 të Grupit Këshillues të Kornizës Evropiane të Kualifikimeve dhe Javën evropiane të validimit.

Përfaqësues të AKK, kanë prezantuar në takimin e 47-të të Grupit këshillues (Advisory Group AG) të Kornizës Evropiane të Kualifikimeve (KEK/EQF), ku Autoriteti tashmë është anëtar. Në agjendën e punës së këtij organizmi ishin; Zhvillimet përkatëse në Evropë, bashkëpunimi në arsim, trajnim dhe çështjet e punësimit si dhe informacione për procesin e Bolonjës (EAC), proceset e referencimit, etj.

Në vazhdën e aktiviteteve ndërkombëtare përfaqësues nga Autoriteti Kombëtar i Kualifikimeve kanë marrë pjesë në aktivitetin e organizuar nga shteti Austriak për grupin këshillues të Kornizës Evropiane të Kualifikimeve (KEK/EQF).



Pamje nga grupi këshillues i Kornizës Evropiane të Kualifikimeve

Po kështu, kemi marr pjesë në Grupin drejtues në kuadër të zhvillimit të standardit të profesionit për murator në partneritet me Republikën e Bajernit në Munih, bashkë me përfaqësues të MAShT dhe Shkollës Gjermano-kosovare "Bau Academy".



Një aktivitet ndërkombëtar ishte edhe pjesëmarrja në Forumin Evropian të Trajnimeve për Sigurim të cilësisë të mbajtur në Vjenë, organizuar nga presidenca austriake e Bashkimit Evropian me pjesëmarrje të përfaqësuesve nga 40 vend të ndryshme. Forumi ishte mundësi për të diskutuar përvojat e nxënësve aktualë dhe atyre të mëparshëm të AAP nga Austria, Finlanda, Rumania dhe Mbretëria e Bashkuar.



Pamje nga pjesëmarrja në Forumin Evropian të Trajnimeve për Sigurim të Cilësisë të mbajtur në Vjenë

Në kuadër të takimeve të grupit Këshillëdhënës të Kornizës Evropiane të Kualifikimeve (KEK), ekspertë të AKK dhe ekspertë të jashtëm kanë marrë pjesë në takimet e Grupit këshillëdhënës të KEK për vitin 2018. Në takime janë shqyrtuar politikat e BE-së për ndërlidhjen e EUROPASS me KEK, ndërlidhjen e ESCOS me KEK, raportet e referencimeve nga Skotlanda dhe Franca, gjë që ka mundësuar kuptimin më profesional dhe formatin e raportimit tonë të ardhshëm lidhur me progresin pas referencimit.



Pamje nga takimet e grupit Këshillëdhës të Kornizës Evropiane të Kualifikimeve (KEK)

Në kuadër të procesit të referencimit të Kornizës Kombëtare të Kualifikimeve (KKK) me Kornizën Evropiane të Kualifikimeve KEK), është finalizuar raporti në gjuhën angleze dhe në atë shqipe, është bërë prezantimi i cili përmban një pasqyrë hyrëse të sistemit tonë arsimor si dhe përgjigjet ndaj 10 kritereve të referencimit.

Në përfundim të vitit ekspertë të AKK kanë qenë në vizitë studimore në Iowa të SHBA për procesin e sigurimit të cilësisë dhe akreditimit. Kjo vizitë u mundësua nga Konsullata e Kosovës në Ajovë dhe Iowa Sister State-urë ndërlidhëse mes Ajovës dhe Republikës së Kosovës. Me këtë rast janë marr informata të vlefshme për sistemin e edukimit në SHBA, gjë që do të mundësojë që kriteret e ngjashme të aplikohen për të lehtësuar lëvizjen e qytetarëve tanë me qëllim arsimimi dhe aftësimi në këtë vend.

Pritet që sipas marrëveshjes në mes dy shteteve njëri nga institucionet e vizituara, DMACC planifikon që të themeloj një degë në Kosovë në të ardhmen.



































Pamje nga aktivitetet e Institucioneve të Arsimit dhe Aftësimit Profesional





www.akkks.rks-gov.net



Qendra e Studentëve Rr. "Agim Ramadani" p.n.
10 000, Prishtinë, Republika e Kosovës

Për me shume vizitojeni faqen:
www.akkks.rks-gov.net